

Tiranë, më 14.11.2025

Njoftim për shtyp

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, z. Altin Dumani, në ushtrim të kompetencës së Komisionerit Publik, autorizoi z. Klodjan Braho, me funksion Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, (njëkohësisht Drejtues i Seksionit Kundër Korrupsionit), për ta përfaqësuar në seancën gjyqësore të datës 14.11.2024, lidhur me shqyrtimin gjyqësor të ankimit kundër vendimit nr.689, datë 24.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Ervin Pollozhani, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjatë paraqitjes së qëndrimit të tij lidhur me dokumentin e titulluar “Gjetje dhe mendim”, të paraqitur gjatë seancës së mëparshme nga vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM), z. Theo Jacobs, përfaqësuesi i Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme z. Klodjan Braho deklaroi se gjetja, e cila lidhet me një nga pasuritë e subjektit të rivlerësimit, është e mbështetur në shkaqet e ankimit dhe shprehu dakordësinë për të vijuar me kryerjen e hetimeve të mëtejshme, të kërkuara nga z. Jacobs.

Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupi gjykues të refuzojë administrimin e dokumentit “Gjetje dhe mendim” si mjet prove, me arsyetimin se bëhet fjalë jo vetëm për një gjetje të paraqitur tej afateve procedurale, por edhe të pabazuar në ndonjë provë apo rrethanë të re që mund të kishte qenë e pamundur të aksesohet më herët. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se bëhet fjalë për një zgjerim artificial të shkaqeve të ankimit përtej afateve ligjore, çka do të cenonte procesin e rregullt ligjor, parimin e ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe të barazisë së armëve mes palëve.

Pasi dëgjoi qëndrimet e palëve, trupi gjykues vendosi në zbatim të nenit 304 të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 49 të ligjit 84/2016, të riçelë hetimin gjyqësor vetëm në funksion të administrimit të gjetjes së paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar dhe të mos vijojë me hetime të mëtejshme të sugjeruara prej tij.

Pasi palët deklaruan se nuk kishin kërkesa të tjera procedurale, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit gjyqësor dhe i ftoi ato në paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare. Për t’u dhënë palëve kohë të arsyeshme për përgatitjen e tyre, seanca gjyqësore u shty për në datën 25.11.2025, ora 11:00.

Seanca publike do të zhvillohet në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Ankimi është publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.